



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

**PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT
INSTITUCIONAL**

NË

“ALBANIAN UNIVERSITY”

2017 - 2022



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	fq.2
2. Misioni.....	fq.3
3. Parimet.....	fq.3
4. Organizimi Institucional.....	fq.5
5. Mësimdhënia, kurrikulat dhe mësimnxënia.....	fq.7
6. Kërkimi Shkencor dhe Inovacioni.....	fq.15
7. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë.....	fq.17
8. Veprimtaria Mbështetëse.....	fq.19
9. Marrëdhëniet me Jashtë.....	fq.22

HYRJE

“**Albanian University**” përfaqëson një nga alternativat serioze, të besueshme, profesionale dhe konkurruese në rrjedhën e zhvillimeve të shumta të Arsimit të Lartë që synon të ofrojë standarde, cilësi, përgatitje bashkëkohore dhe përshtatje me tregun e punës vendas, rajonal e më gjërë. Institucioni është i orientuar drejt vlerave dhe formave të reja të kërkim-zhvillimit, duke synuar të formojë specialist të zotë që marrin përsipër e u përgjigjen me dinjitet sfidave të të jetuarit në një shoqëri të hapur.

“**Albanian University**” ka si kolona të forta për besim dhe sukses orientimin drejt Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, profesionalizmin e përkushtimin e shkallës së lartë, bashkëpunimin dhe partneritetin e vazhdueshëm e të pandërprerë me studentët dhe faktorët e tjerë që motivojnë dhe nxisin progres. Institucioni krijon mundësi të mëdha për arritjen e potencialeve të plota fizike, intelektuale, emocionale, sociale dhe shpirtërore që nevojiten në një botë pa kufij. Kjo strategji hartohet me qëllim për të qenë e pajtueshme me prirjet kryesore të zhvillimit të AL në Evropë dhe në botë, dhe në veçanti, duke qenë në përputhje të plotë me procesin e Bolonjës. Qëllimi i saj është të përmirësojë Albanian University, në drejtime të ndryshme, në mënyrë që ky Institucion të radhitet mes Institucioneve cilësore të Arsimit të lartë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe të forcojë bashkëpunimin me IAL më në ze perëndimore dhe më gjerë. Strategjia përfshin gjerësisht ndjekjen e orientimeve kryesore me rëndësi për sukses në të ardhmen. Këto drejtime strategjike identifikohen dhe shprehen nëpërmjet një sërë objektivash të ndërlidhura.



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

Misioni i Albanian University


Universiteti ka për mision kryesor:

- a. të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies;
- b. të ofrojë programe të studimeve në të tre ciklet e studimit;
- c. të zhvillojë punë shkencore në të gjitha fushat që ajo mbulon dhe të përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj;
- d. të realizojë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese;
- e. të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës;
- f. të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- g. të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore;
- h. të ofrojë shërbime, në përputhje me misionin e tij;
- i. të mbështesë dhe realizojë aftësimin e personelit akademik, duke i garantuar mundësi të barabartë për të përfituar nga financimet për kërkim shkencor.

AU përbën një komunitet të pavarur të hapur i cili që kërkon të jetë pjesë e denjë e botës dhe e së ardhmes. Në zhvillim të misionit të tij AU ka si objektiv të shoqërojë dhe të mbështesë studentët në mënyrë që ai të zhvillojë më së miri potencialitetin e ti. Të nxisë krijimin, transferimin dhe përparimin e dijes për t'ju përgjigjur nevojave për një formimimi të lartë bazuar në kërkimin shkencor në të mirë të shoqërisë.

Parimet bazë mbi të cilat mbështetet "AU" në realizimin e Misioneve të tij

Në realizimin e misioneve të tij, universiteti vepron në respekt të të drejtave themelore të njeriut, të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kartat, Deklaratat dhe Konventat evropiane dhe ndërkombëtare. Universiteti promovon zhvillimin e lirë të studimit, procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor, bashkëpunimin në shkallë të gjerë me institucione të arsimit të lartë dhe të kulturës, kombëtare dhe ndërkombëtare; hapjen ndaj komunitetit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar; bashkëpunimin me administratën shtetërore; raportin e frytshëm bashkëpunues me ndërmarrjet dhe bizneset, me botën e punës dhe të profesioneve, me organizatat jo-qeveritare. Universiteti është i pavarur nga çdo lloj orientimi ideologjik, politik apo fetar; vepron në përputhje dhe në respekt të parimeve kushtetuese dhe të dispozitave ligjore në fuqi; garanton lirinë e studimit, të mësimdhënies dhe të kërkimit të lirë shkencor. Universiteti aspiron përmbushjen e misionit të tij arsimor në frymën e lirisë dhe të respektit të dinjitetit human, pluralizmit të ideve, transparencës së procedurave, si dhe promovon mendimin e lirë të pedagogëve dhe studentëve duke u siguruar mundësi të barabarta për punësim dhe studim në funksion të një qëllimi të përbashkët. AU ofron



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

përgatitje dhe diplomim të studentëve për një spektër të gjerë njohurish, të domosdoshme për zhvillimin e karrierës dhe të ardhmes së tyre, dhe që krijon mundësi për nxitjen e pasionit për rinovim njohurish përmes të mësuarit gjatë gjithë jetës. Studentët në këtë institucion përgatiten për një botë të globalizuar në ndryshim, si kontribuues përmes dijeve dhe përmes shërbimit duke qënë profesionistë të denjë e të shërbejnë si të tillë në të gjithë botën. Duke ndjekur zhvillimet arsimore, shkencore, ekonomike e shoqërore në vend dhe jashtë tij, AU është e angazhuar për respektimin dhe ruajtjen e vlerave që lidhen me diversitetin e elementëve etnikë, socialë dhe kurrikularë duke pasqyruar njëvetëdije globale. Kështu, AU mbetet i hapur për të rekrutuar studentë të kategorive të ndryshme shoqërore dhe nacionale duke bërë kujdes që të mbetet i angazhuar për të përsosur procesin mësues, kërkimin shkencor, edukimin qytetar e kulturor, në funksion të ofrimit të një shërbimi publik për të gjithë, në një shoqëri të hapur.

AU beson në përgatitjen dhe zhvillimin e gjithanshëm të studentëve, si kolona të nevojshme për të shërbyer në shoqëri si qytetarë të shkolluar dhe të kualifikuar. Duke vlerësuar e zbatuar eksperiencat të traditës për mësimdhënie dhe kërkim shkencor, AU mbështet dhe nxit rrugë e metoda të reja për zhvillimin profesional e kulturor të studentëve. Për këtë qëllim, krijohen mundësi të shumta edhe në bashkëpunim me Këshillin Studentor për praktika mësimore, programe kulturore dhe artistike, si dhe për pjesëmarrje në veprimtari çlodhëse e të dobishme për publikun dhe në shërbim të komunitetit. Të udhëhequr nga vlerat dhe të përqendruar te njerëzit, ky institucion synon të përdorë njohuritë që transmeton tek studentët për të ndryshuar të ardhmen e jetës së tyre, duke kontribuar kështu për një shoqëri produktive dhe të begatë. Për përmbushjen e misionit të tij, institucioni ofron një ofertë akademike elastike dhe të mbështetur nga epërsia në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke krijuar një pjesëmarrje aktive të studentëve, kërkim shkencor të zbatuar me njohje dhe ndikim brenda vendit, bashkëpunim me biznesin dhe sipërmarrjet, duke luajtur një rol kyç në zhvillimin e rrjeteve që mbështesin lidhjet ndërkombëtare përmes partnerëve dhe bashkëpunëtorëve tanë. AU ka si kolona të forta për besim dhe sukses: orientimin drejt Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, profesionalizmin e përkushtimin, bashkëpunimin dhe partneritetin e vazhdueshëm e të pandërprerë me studentët dhe faktorët e tjerë që motivojnë dhe nxisin progres.

Objektivat strategjike për realizimin e misionit të Universitetit në pesë vitet e ardhshme do të përqendrohen në drejtimet e mëposhtme:

1. Objektivat e Organizimit Institucional;
2. Mësimdhënia, kurrikulat dhe mësimnxënia me në qëndër formimin e studentëve;
3. Kërkimin shkencor dhe Inovacionin;
4. Sigurimin e brendshëm të cilësisë;
5. Veprimtaritë shërbyese;
6. Marrëdhëniet me jashtë.



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

1. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Kuadri institucional aktual në Albanian University kërkon t'i përgjigjet zhvillimeve të kohës. Aktualisht Institucioni kontribuon, por do të vazhdojë akoma më shumë të kontribuojë në zhvillimin e vendit në veçanti dhe atë rajonal e më gjërë në përgjithësi nëpërmjet konsolidimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të Institucionit. Plani Strategjik është dokumenti i planifikimit që përshkruan misionin, objektivat strategjike dhe akademike të Universitetit. Ai duhet të përfshijë të gjithë aktorët e universitetit, duke ditur se zbatimi i tij ka nevojë për kontributin e të gjithëve. Një përfshirje e tillë e të gjithë aktorëve, kërkon një ndjenjë të fortë të identitetit e cila ushqehet jo vetëm me ndarjen e objektivave, por sidomos me vëmendje mbi të gjitha ndaj studentit dhe në aspiratat e tij më të larta, në të gjitha fazat e programit të trajnimit. Kjo vlen për të gjitha fushat në të cilat institucioni është përgjegjës, por mbi të gjitha në ofertën didaktike që ai ofron, me një qëndrueshmëri të cilësinë e formimit të studentit.

Në fakt, në përcaktimin e strategjive në përmbushje të misionit të institucionit, AU përveç ruajtjes së vazhdimësisë së objektivave të hartuara nga "Plani Strategjik 2013-2017 duhet të përballet edhe me ndryshimet e shpeshta të legjislacionit që rregullon këtë fushë. Gjithsesi, kjo strategji nuk mund të mos përfshijë përballjen e vlerave, në planifikimin e ofertës akademike, me vullnetin e hapjes me botën e jashtme që duhet të karakterizojë institucionin për 5 vitet e ardhshme. Në këtë mënyrë është e domosdoshme që plani strategjik të jetë koherent me zhvillimet globale, e ta bëjë institucionin që ta vëjë në zbatim duke qenë denjesisht pjesë e një botë në ndryshim e cila duhet ti konsolidojë vlerat e përbashkëta. Kjo pra, është sfida, që të transmetojë kulturë dhe vlera për të ardhmen dhe të trajtojë çështje të nevojave dhe vlerave të panjohura për të cilat institucioni vendos qëllim në bazë të bashkëpunimeve që ka realizuar dhe synon ti shtojë e konsolidojë në të ardhmen. Në këtë kontekst AU nuk duhet vetëm të jetë i orientuar drejt së ardhmes por duhet të orientojë vetë të ardhmen, në këtë mënyrë studentët me aftësitë dhe aspiratat e tyre duhet të transformohen në një energji dhe mundësi të madhe. Kjo mund të arrihet duke orientuar procesin mësimdhënës dhe mësimnxënës nëpërmjet rritjes së cilësisë, në mënyrë që studenti të ndjehet vërtet në qëndër të kësaj strategjie.

Siç qartësohet më lartë Institucioni gjen tek studenti dhe tek shoqëria dy bashkëpunorët më të ngushtë dhe për këtë arsye AU ofron programet e studimit në bazë të nevojave të tyre dhe padyshim e orienton strukturën e saj për tju përshtatur ndryshimeve të këtyre nevojave duke krijuar identitetin e tij në formimin akademik, kërkimor dhe profesional.



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

Gjithmonë në kuadër të zhvillimit institucional objektivat afatmesme të Institucionit do të jenë si më poshtë:

- Konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të zyrave qendrore administrative si p.sh. zyra e Karrierës dhe Alumnit, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. Të gjitha këto zyra janë të miratuara në Organigramën e re Bazuar në ligjin e Ri të arsimit të lartë Nr. 80, 07.2015.
- Kualifikimi i mëtejshëm i stafit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
- Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i strukturave të kërkimit shkencor – zyra e Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve akademike si dhe komisioni për kërkimin shkencor dhe botimin
- Institucioni do të impenjohet në zgjerimin e zyrës së Karrierës dhe Alumnit e cila është zyra që mban lidhjet me tregun e punës dhe ofron një shërbim tejet të rëndësishëm për studentët e sapodiplomuar. Zyra do të zhvillojë një monitorim të kujdesshëm të të gjitha ofertave të publikuara për punësim, nga subjekte privatë dhe publikë dhe do të asistojë studentët në prag diplomimi dhe të sapodiplomuar gjatë procesit të aplikimit për punësim. Është kjo zyrë që do të kujdeset për mbajtjet e lidhjeve me studentët e diplomuar, kontributi i të cilëve në zhvillimin e mëtejshëm të Institucionit konsiderohet thelbësor.
- Konsolidimin dhe zhvillimin e Zyrës së Projekteve që do të ndihmojë Institucionin dhe stafin akademik në përthithjen e projekteve kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet aderimit në programet Horizon 2020 dhe Erasmus + duke e vendosur Albanian University si Universitet partner në kuadër të mobilitetit të stafit dhe të studentëve.
- Në pesë vitet e ardhshme Institucioni do të impenjohet në drejtimin e përmirësimeve të vazhdueshme dhe të konsolidimit të programeve mësimore në përputhje me objektivat e formimit për programet e studimit që ofron. Gjithashtu Albanian University do të impenjohet në hapjen e Programeve të studimit në gjuhë të Huaj.
- Ngritja e laboratorëve kërkimorë shkencorë në Fakultetet e Farmacisë dhe Stomatologjisë mbështetur dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit me Universitete të Huaja.
- AU do të ofrojë mbështetje për kualifikim të mëtejshëm të diplomuarve si dhe të stafit akademik.
- Ndërtimi i një Korpusi qendror, i cili do të jetë një ndërtesë moderne, e pajisur me të gjitha lehtësirat e nevojshme për të bërë të mundur një studim sa më cilësorë.



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

**2. MËSIMDHËNIA, KURRIKULAT DHE MËSIMNXËNIA ME NË QËNDËR
FORMIMIN E STUDENTIT**

Programet aktuale të ofruara në Albanian University:

Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Fizioterapi	Bachelor
Infermieri	Bachelor
Farmacii	Dip Integruar Msc
Stomatologji	Dip Integruar Msc
Infermieri Kirurgjikale	Master profesional
Implantologji	Specializime afatgjata
Kirurgji	Specializime afatgjata
Orthodonci	Specializime afatgjata
Kirurgji oro-maxillo-faciale	Specializime afatgjata
Endodonti	Specializime afatgjata
Dentistri Pediatrike	Specializime afatgjata
Prostodontikë	Specializime afatgjata
Periodontologji	Specializime afatgjata
Shkenca Farmaceutike	Doktoratë

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike

Menaxhim Biznesi	Bachelor
-------------------------	----------



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

Financë Bankë	Bachelor
Dizajn	Bachelor
Teknologji Informacioni	Bachelor
Inxhinieri Mekatronike	Bachelor
Inxhinieri Elektronike	Bachelor
Inxhinieri Kompjuterike	Bachelor
Inxhinieri Elektrike	Bachelor
Arkitekturë	Dip Integruar Msc
Menaxhim Bankar	Master i shkencave
Administrim Biznesi	Master i shkencave
Inxhinieri Elektronike	Master i shkencave
Teknologji Informacioni	Master i shkencave
Inxhinieri Mekatronike	Master i shkencave
Inxhinieri Kompjuterike	Master i shkencave
Menaxhim Bankar dhe Financiar	Master profesional
Administrim Biznesi	Master profesional
Menaxhim Shëndetsor	Master profesional
Arkitekturë	Doktoratë
Financë	Doktoratë



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

Fakulteti i Shkencave Shoqërore

Shkenca Politiko - Administrative	Bachelor
Psikologji e Përgjithshme	Bachelor
Anglisht	Bachelor
Shkenca Juridike	Bachelor
Mësuesi për Arsimin Parashkollor	Bachelor
Mësuesi për Arsimin Fillor	Bachelor
Administrim Publik me profile; a. Politika publike dhe BE; b. Politika publike dhe qeverisje	Master i shkencave
Psikologji Klinike	Master i shkencave
Shkenca Juridike me drejtime: a. Marrëdhënie Ndërkombëtare; b. E Drejtë Publike dhe Administrative; c. E Drejtë Private; ç. E Drejtë Ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian; d. E Drejtë Penale	Master i shkencave
Psikologji Ligjore	Master i shkencave
Psikologji Zhvillimi dhe Shkollore	Master i shkencave
Këshillim Psikologjik	Master i shkencave
Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile: a. Studime Europiane; b. Gjeopolitikë dhe marrëdhënie rajonale	Master i shkencave
Mësuesi për Arsimin Fillor	Master i shkencave
Shkenca Penale	Master profesional
E Drejtë Private	Master profesional
Qeverisje dhe Administrim Publik	Master profesional



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

Pedagogji me profile: a. Didaktikë; b. Menaxhim Arsimi	Master profesional
Psikologji Klinike	Master profesional
Psikologji Shkollore	Master profesional
Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci	Master profesional
Studime mbi sigurinë	Master profesional
E Drejtë Europiane dhe e Kontratave	Doktoratë
Shkenca Administrative	Doktoratë
Psikologji Klinike	Doktoratë
E Drejtë dhe Procedurë Penale	Doktoratë
Marrëdhënie Ndërkombëtare	Doktoratë

Albanian University për të plotësuar ofertën formuese në të treja ciklet e studimit ofron programet e studimit të ciklit të tretë **“Specializime në stomatologji”** si më poshtë:

- Endodonti,
- Prostodontikë
- Kirurgji,
- Kirurgji Oro-Maksillo-Faciale,
- Orthodonci,
- Dentistri Pediatrike,
- Implantologji,
- Periodontologji

Si dhe programet e studimit në **Doktoraturë** si më poshtë:

- Financë
- E drejtë europiane dhe e kontratave
- E drejtë dhe procedurë penale
- Psikologji klinike



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

- Shkenca administrative
- Marrëdhënie ndërkombëtare,
- Arkitekturë
- Shkenca Farmaceutike

Këto programe janë realizuar me përfshirjen e stafit të huaj në sajë të marrëveshjeve që institucioni ka lidhur. Përfshirja e stafit të huaj në këto programe studimin është një vlerë e shtuar për to sepse ndërthur eksperiencën e tyre të konsoliduar me aspiratat e larta të institucionit për ta kompletuar ofertën formuese të studentit. Kjo eksperiencë pozitive do të jetë edhe baza e përmirësimit të ciklit të tretë të studimit për ta pasuruar akoma më shumë në të ardhmen.

Në pesë vitet e ardhshme Institucioni do të impenjohet në drejtimin e përmirësimeve të vazhdueshme dhe të konsolidimit të programeve mësimore në përputhje me objektivat e formimit dhe impaktit shoqëror për programet e studimit që ofron.

Gjithashtu Albanian University do të impenjohet në hapjen e Programeve të studimit në gjuhë të Huaj. Aktualisht është aplikuar për miratim në MAS për hapjen e 6 programeve të studimit në gjuhë italiane si më poshtë:

- Master i Shkencave në Stomatologji
- Master i Shkencave në Farmaci
- Bachelor në Shkenca Infermieristike
- Bachelor në Fizioterapi
- Master Profesional në Terapi Manuale

Në Albanian University, objektivi tjetër është përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe i përvetësimit të dijeve nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe të kulturës së cilësisë. Lidhur me metodat dhe stilin e mësimdhënies, institucioni do të impenjohet vazhdimisht në drejtimin e favorizimit të metodave moderne interaktive të mësimdhënies të cilat inkurajojnë të menduarit kritik dhe vendosin studentin në qendër të mësimdhënies.

Edhe përmbajtja e lëndëve do të vazhdojë procesin e rishikimit në mënyrë që ato (përmbajtjet) të mos rezultojnë të ngushta dhe tradicionale, por të tilla që t'u japin studentëve alternativa zgjedhjesh, fleksibilitet në studime dhe informacion të përditësuar. Teknikat e mësimdhënies dhe përmbajtja e kurrikulave do të përshtaten me nevojat që dikton tregu i punës. Numri i të punësuarve në sektorin privat po rritet me shpejtësi. Një numër i madh të diplomuarish do të punësohen në të ardhmen në veprimtari të sektorit privat që sot mund të mos ekzistojnë - dhe ata duhet të jenë të përgatitur për t'u riorientuar profesionalisht dhe ripunësuar disa herë gjatë jetës së tyre. Ndaj dhe është e nevojshme që të diplomuarit duhet të jenë të përgatitur me shprehi të përgjithshme dhe të transferueshme, si ato



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

të analizës, të të menduarit, arsyetimit, paraqitjes dhe komunikimit që janë bazë e indikatorëve të Dublinit. Ky ndryshim është i rëndësishëm për të ardhmen e arsimit dhe në drejtim do të përqendrohen edhe investimet për zhvillimin e burimeve njerëzore në të ardhmen.

Kualifikime jashtë vendit : Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi Institucionale me disa Universitete perëndimore. Në këto marrëveshje është parashikuar mundësia e shkëmbimeve afatshkurtra të personelit akademik. Këto marrëveshje si edhe marrëveshje të tjera që institucioni ka si synim të lidhë në 5 vitet e ardhshme do të përbëjnë themelin e rritjes së cilësisë në funksion të ndërkombëtarizimit të ofertës formuese universitare. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar deri tani dhe do të vazhdojë t'i kushtohet rekrutimit të personelit të kualifikuar jashtë vendit për të krijuar ura bashkëpunimi si edhe për të shkruarë akoma më lehtë qëllimin ndërkombëtarizues;

Për pjesën tjetër të stafit akademik do të organizohen në mënyrë sistematike kurse afatshkurtra për metodat e mësimdhënies dhe veprimtari për shkëmbim përvoja në nivel IAL-je, rajonale e kombëtare;

Një feed-back i rëndësishëm do të jetë dhe reagimi nga studentët të cilët janë përgjithësisht gjykesit më të mirë të mësimdhënies. Ata do të trajnohen për aspekte specifike të vlerësimit të saj, si dhe për mënyrën e strukturimit të formulimit të opinioneve të tyre.

Plani i mësipërm do të zbatohet nëpërmjet ndihmesës së njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe mbështetjes nga komisioni për kurrikulat dhe mësimin.

Në këtë kontekst, një nga ndryshimet dhe investimet primare do të drejtohet drejt fuqizimit dhe kualifikimit të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë në mënyrë që ajo të operojë me standardet evropiane, dhe, për më tepër, të garantojë që çdo nismë për hapjen e programeve apo cikleve të reja, të plotësojnë kriteret dhe standardet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Plani i veprimit do të përfshijë fonde të veçanta investimi të dedikuara nga Bordi Administrativ.

Gjithashtu, në mënyrë që të kemi një mësimdhënie cilësore dhe me informacion të pasur, personeli akademik do të angazhohet në një punë të thelluar kërkimore dhe pedagogjike që t'i lejojë ndjekjen në vijimësi të zhvillimeve më të fundit në fushën përkatëse. Për përparimin në karrierë akademike të personelit është i nevojshëm një kontribut kërkimor i mjaftueshëm, i konkretizuar në gradën shkencore "Doktor", si dhe një përvojë e mjaftueshme në mësimdhënie. Kualifikimi i personelit akademik do të bëhet i mundur si nëpërmjet financimit të studimeve të doktoraturës për një pjesë të stafit pranë Universiteteve perëndimore, si dhe nëpërmjet përmirësimit të programeve ekzistuese të studimit të doktoratës apo hapjen e programeve të reja në Albanian University. Një kualifikim i mëtejshëm do të realizohet nëpërmjet mobilitetit të tyre në universitete jashtë vendit si në nivel mësimdhënieje por edhe të kërkimit shkencor nëpërmjet Erasmus PLUS dhe përfitimit të projekteve kërkimore të Programit Horizon 2020.



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

Universiteti siguron gjithashtu ambientet e duhura laboratorike, të radhitura më poshtë, të cilat i shërbejnë si promotorë të zhvillimit të procesit mësimor, ashtu dhe atij të kërkimit shkencor. Këto ambiente janë të pajisura në pjesën më të madhe me të gjitha aparaturat dhe lehtësirat e duhura për zhvillimin sa më cilësor të procesit mësimor. Albanian University do të vazhdojë të investojë në përmirësimin e kushteve mësimore duke pajisur laboratorët e mëposhtëm me pajisjet më të reja dhe cilësore sipas specifikave.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Laboratorë në funksion të departamentit të Farmacisë:

- Laboratori i Kimisë Analitike 1
- Laboratori i Kimisë Analitike 2
- Laboratori i Teknologjisë Farmaceutike
- Laboratori i Kimisë së Përgjithshme Inorganike
- Laboratori i Kimisë Farmaceutike
- Laboratori i Farmakognozisë
- Preparatori i Teknologjisë Farmaceutike dhe Farmakognozisë
- Preparatori i Kimisë Farmaceutike, Kimisë Toksikologjike dhe Metodave Instrumentale të Analizës
- Dhoma e Aparaturave
- Laboratori i Kimisë Toksikologjike dhe Metodave Instrumentale të Analizës
- Laboratori i Anatomisë I
- Laboratori i Anatomisë II
- Laboratori i Fizikës

Departamenti i Stomatologjisë strukturohet mbi bazë katedrash, që janë:

- Katedra e terapisë me degët dentistri operative paraklinike-klinike, endodonti paraklinike-klinike, dentistri estetike.
- Katedra e dentistrisë pediatrike me degët dentistri pediatrike, profilaksi, nutricion.
- Katedra e protetikës me degët: morfologji dentare, njohuri materiale, protetikë paraklinike, protetikë e lëvizshme parciale, proteikë totale, protetikë fikse, ortodonti paraklinike-klinike.



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

- Katedra e kirurgjisë orale dhe OMF me degët anestezi, kirurgji orale, kirurgji OMF dhe radiografia .
- Katedra e periodontologjisë me degët: periodontologji paraklinike-klinike, diagnozë orale, patologji omf, implantologji, mjekësi orale.

Për realizimin e programit mësimor në ndihmë të Departamentit të Stomatologjisë, vjen Klinika Universitare, me nënndarjen: në salla të praktikës paraklinike (2 laboratorë me afërsisht 50 vende pune) ku aplikohen punimet dentare në pupac (kukulla-model) dhe në 6 salla klinike dhe 1 sallë filtri, ku kryhen punimet klinike nga ana e studentëve.(me 77 unite dentare):

- salla e terapisë (dentisteri e endodonti),
- salla e pedodontisë për trajtimin e moshave 3-16 vjeçare;
- salla e ortodontisë;
- salla e protetikës fikse e të lëvizshme së bashku me laboratorin e studentëve;
- salla e kirurgjisë ambulatorë;
- salla e kirurgjisë me hospitalizim 24 orësh.
- salla e periodontologjisë dhe e sëmundjeve të mukozave

Krahas këtyre sallave ekziston edhe salla e ekzaminimit radiografik dixhital, që është në ndihmë të studentëve për vlerësimin dhe ekzaminimin e rasteve klinike. Mjediset laboratorike shfrytëzohen jo vetëm për aktivitetin mësimor, por dhe punë kërkimore shkencore nga ana e pedagogëve dhe studentëve të cilët punojnë për temën e diplomës dhe punimet që prezantojnë në konferencat studentore.

Laboratorë në funksion të departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë:

- Sallë praktike Infermieri
- Sallë praktike Fizioterapi

Fakulteti I Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike:

Laboratorë në funksion të departamentit të Arkitekturës:

- Laboratori i Projektimit Arkitektonik,
- Laboratori i Modelimit dhe Vizatimit të Lirë,
- Laboratori i C.A.D
- Laboratori i Informatikës



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

Laboratorë në funksion të departamentit të Inxhinierisë:

- Laborator i Kimisë
- Laboratori i Fizikës
- Laboratori i Elektroteknikës
- Laboratori i Matjeve
- Laboratori i Elektronikës analitike
- Laboratori Elektroteknikës shifrore
- Laboratori i Simulimeve

Në Fakultetin e Shkencave shoqërore praktikat mësimore zhvillohen pranë Institucioneve të ndryshme me të cilat Albanian University ka marrëveshje Bashkëpunimi. Për të rritur cilësinë e praktikave Albanian University do të zgjerojë, në pesë vjeçar in e ardhshëm, rrethin e Institucioneve me të cilat bashkëpunon dhe ka nënshkruar marrëveshje institucionale dypalëshe.

3. KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI

Kërkimi shkencor në *Albanian University* është orientuar dhe do të vazhdojë të konsolidohet:

Së pari, në funksion të mësimdhënies.

Veprimtaria e kërkimit dhe zhvillimit që kryhet në *Albanian University*, duhet të synojë në rritjen e cilësisë së arsimimit, duhet të sigurojë integrimin e kërkimit me mësimin. Ajo duhet t'u japë studentëve aftësi metodologjike për kërkim, të japë mundësi të vazhdueshme në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, të përmirësojë kualifikimet e personelit akademik të *Albanian University*, si dhe të krijojë mjete materiale për zhvillimin dhe punën në institucion, etj.

Së dyti, në përshtatje të ofertës universitare me nevojat e tregut të punës.

Albanian University duhet të kryejë kërkim shkencor bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese në mënyrën e përcaktuar në statutin e Albanian University, sipas objektivave specifike të institucionit në këto drejtime.

Së treti, në bazë të marrëveshjeve me të tretët.

Albanian University mund të kryejë për të tretët edhe shërbime të ndryshme të kualifikuara, si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime klinike, informacioni e të tjera që rregullohen



Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022 Albanian University

në statutin dhe rregulloret e tij. Këto veprimtari do të kryhen me financime të palëve të interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari duhet të shkojnë tërësisht në favor të institucionit.

Orientuar nga vizionet dhe politikat e zhvillimit, Albanian University ka krijuar një strukturë efektive institucionale horizontale e vertikale, që përbëhet prej: zyra e koordinimit të kërkimit shkencor dhe botimeve akademike, që koordinon punën e saj pranë njësisive bazë dhe Kryesore.

Kërkimi shkencor në planin strategjik synon:

- T'i krijojë mundësi stafit akademik dhe studentëve për të zhvilluar kërkimin e tyre shkencor.
- T'i shërbejë ngritjes së nivelit të mësimdhënies dhe zhvillimit akademik të brendshëm në Universitet në mënyrë që studentët dhe pedagogët të jenë promovuesit e një kulture nxitëse, bazuar në parimet e të menduarit kritik.
- Të japë kontributin e tij për thellimin e njohurive dhe dijeve njerëzore si edhe aplikimeve të tyre profesionale në vend.
- Të bëjë të mundur një impakt teorik dhe praktik mbi shoqërinë, ekonominë, shkencat mjekësore dhe me tej duke i transferuar njohuritë e zhvilluara me gjerë se sa komuniteti akademik i brendshëm në Universitet.

Krahas synimeve strategjike afatgjata të cilat lidhen me vizionin e *Albanian University*, si mjete për arritjen e këtyre synimeve janë një grup me objektiva dhe prioritete si:

- Ndërgjegjësimi i stafit akademik për domosdoshmërinë e përfshirjes së tij në veprimtari kërkimore-shkencore dhe krijimi i mundësive për zhvillimin e kërkimit shkencor. Për realizimin e këtij objektivi *Albanian University* ka vendosur departamentin në qendër të punës kërkimore dhe studimore;
- T'i shërbejë ngritjes së nivelit të mësimdhënies dhe zhvillimit akademik të brendshëm në Universitet në mënyrë që studentët dhe pedagogët të jenë promovuesit e një kulture nxitëse që bazohet në principet e të menduarit kritik. Kjo do të realizohet nëpërmjet përcaktimit të tryezave të rumbullakëta, diskutimeve dhe projekteve si pjesë e rëndësishme në kurrikulat e studimit sidomos për studentët e niveleve të dyta dhe të treta të studimit;
- Të japë kontributin e tij në drejtim të thellimit të njohurive dhe dijeve njerëzore si edhe aplikimeve të tyre profesionale në vend. Të bëjë të mundur një ndikim teorik dhe praktik mbi shoqërinë, ekonominë, shkencat mjekësore dhe me tej duke i transferuar njohuritë e zhvilluara me gjerë sesa komuniteti akademik i brendshëm në Universitet. Nëpërmjet



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

kërkimit shkencor i jepet prioritet rritjes së dialogut social midis aktorëve të rëndësishëm në fushat e ndryshme të zhvillimit të vendit por edhe më gjërë;

4. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË

Njësia e Sigurimit të brendshëm të cilësisë kryen periodikisht vlerësimin e brendshëm të cilësisë bazuar në standartet shtetërore të cilësisë, Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë si dhe Udhëzimeve të ASCAL. Ajo ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e Institucionit.

NjSBC është përgjegjëse për proceset e akreditimit, rankimit dhe çdo procedure tjeter të vleresimit të zhvillimit të aktivitetit akademik të Universitetit të cilat kryhen në afatet e përcaktuara në ligj apo akte nënligjore. NjSBC luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e efikasitet dhe transparencës institucionale.

Qëllimi dhe objektivat


Qëllimi bazë i NjSBC është të mbështesë dhe të sigurojë cilësinë në të gjitha nivelet e funksionimit të insitucionit. Kjo gjë realizohet nëpërmjet ngritjes së disa objektivave më specifike që i vijnë në ndihmë sigurimit të cilësisë,

Konkretisht:

- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor
- Përmirësimi i vazhdueshëm i programeve të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës
- Rritja dhe zhvillimi profesional i stafit akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime të ndryshme të cilat në bazë kanë mësimdhënien
- Mbështetja e njësisive bazë të AU në përmbushjen e misionit të tyre me një nivel të lartë performance.



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**




Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me grupet e sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë synon që në të ardhmen të punojë për:

- Nxitjen dhe përmirësimin e kulturës së cilësisë në Institucion
- Nxitjen e reflektimit mbi atë çfarë është arritur dhe identifikimin e asaj çfarë duhet të arrihet në të ardhmen për të siguruar ekselencë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe në procesin e kërkimit shkencor, në bazë të një cikli cilësie, i cili bazohet në disa hapa, si më poshtë:
 - a. Identifikimi i praktikave të mira dhe fushave për përmirësim
 - b. Hartimi i planeve për ndryshim në fushat prioritare
 - c. Identifikimi i mjeteve që i vinë në ndihmë përmirësimit
 - d. Implementimi i planit të ngritur
 - e. Monitorimi i procesit
- Përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës, duke ndjekur një procedure të tillë e cila inicion me:
 - Propozimin në nivel departamenti për hapjen e programeve të reja të studimit apo ndryshimin e atyre ekzistuese. Propozimi mund të bëhet nga pedagogu i lëndës, nga studentë apo mund të lind si domosdoshmëri e përshtatjes me tregun e punës. Grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti shqyrton dhe punon për hartimin apo ndryshimin e programit të studimit.



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

- Drejtuesi i departamentit dërgon propozimin në Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe për dijeni në Dekanat.
- Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, e cila shqyrton dhe vlerëson nga ana teknike propozimet e departamentit, e dërgon informacionin në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë.
- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e paraqet këtë informacion pranë Komisionit për vlerësimin Institucional, i cili e paraqet pranë Senatit Akademik për miratim.



5. VEPRIMTARITË MBËSHTETËSE

Veprimtaritë mbështetese të cilave u referohet objektivi i pestë ndahen në veprimtari në mbështetje të studentëve dhe në veprimtari në mbështetje të komunitetit.



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

Veprimtari në mbështetje të studentëve:

“Albanian University” i kushton rëndësi të vazhdueshme mbështetjes së kategorive sociale dhe bursave të studimit, si pjesë e përgjegjësisë ndaj komunitetit. “Albanian University” ndjek një politikë mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara si dhe studentëve nga komuniteti Rom dhe Egjiptian sipas ligjeve në fuqi dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Ndjekia e procesit mësimor merr një vëmendje të veçantë në aspektin e mbështetjes dhe lehtësimit të procesit të të nxënimit dhe qëndrimit në klasë.

Kategoritë e bursave që ofrohen nga “Albanian University” janë:

1. Programi i ekselencës;
2. Bursa për të verbrit, invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik;
3. Bursa Sociale;
4. Bursa për pjestarë të së njëjtës familje;
5. Bursa për fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës;
6. Bursa mbështetëse për shtresat në nevojë.

Albanian University impenjohet jo vetëm që të vazhdojë traditën e Programit të Ekselencës dhe bursave por edhe të aktivizojë forma të tjera mbështetjeje financiare si programi i bursave për studentët të cilët në bazë të marrëveshjeve me Institucione të huaja fitojnë të drejtën për të kryer kërkime për temën e diplomave pranë këtyre të fundit.

Në shërbim të studentëve janë ngritur dhe funksionojnë pranë Albanian University edhe disa struktura si zyra e koordinimit dhe mbështetjes për studentët dhe zyra e karrierës dhe Alumnit. Zyra e koordinimit dhe mbështetjes për studentët koordinon aktivitetin shkencor, akademik, social e kulturor të jetës studentore brenda Albanian University. Në këtë zyrë vetë studentët janë mediatorë të problemeve të tyre duke i dhënë kësaj zyre funksionin e këshilluesit për jetën profesionale. Zyra zyra e karrierës dhe Alumnit zhvillon lidhjet mes studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ, me botën e biznesit. Gjithashtu shërben si ndërlidhëse dhe ndihmon konsultat e studentëve me pedagogët dhe asistentë pedagogët mbi informacionet akademike. Nëpërmjet kësaj zyre studentët këshillohen se si të bëjnë aplikime të ndryshme për shkollat verore, specializime, mastera, vende pune. Një strukturë tjetër e ngritur në Albanian University është Këshilli Studentor. Nëpërmjet Këshillit Studentor të Albanian University, krijohet akses për studentët në hartimin e politikave, programeve dhe veprimtarive të ardhshme të Universitetit. Në vitet e ardhshme Albanian University do të mbështesë, edhe financiarisht, zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve të strukturave të mësipërme.

Mbështetje të tjera për studentët

Bibliotekat dhe sallat e studimit



Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022 Albanian University

Në mjediset e Albanian University janë vendosur tre biblioteka, që shërbejnë dhe si salla studimi për studentët. Në to ruhen një numër i madh skedarësh me tituj të librave universitarë dhe botime artistike. Albanian University parashikon krijimin e një biblioteke qendrore e cila do të përfshijë një numër akoma më të madh titujsh, si dhe regjistrime në biblioteka të ndryshme online dhe në Revista shkencore prestigjioze perëndimore.

Shërbimi i sekretarisë online

Albanian University po punon për Implementimin e një sistemi të sekretarisë *online* me parametra më bashkëkohorë për të lehtësuar informimin sa më të mirë të studentëve

Laboratorët kompjuterikë

Një shërbim jo pak i rëndësishëm është dhe Laboratori Kompjuterik i pajisur me teknologjinë më të fundit multimediale. Janë tridhjetë kompjuterë të lidhur në rrjet dhe një ploter i madh, që shfrytëzohen për leksione apo seminare. Po ashtu sallat e leksioneve janë të pajisur me videoprojektorë, me anë të cilave lektorët bëjnë shpjegimin vizual të lëndëve në të gjitha degët.

Studentët e Albanian Universitetit janë të pajisur me adresat e tyre, nëpërmjet të cilave u jepet mundësia e hyrjes në sistemin e kompjuterëve, laboratorët kompjuterikë, si dhe shërbimet e tjera kompjuterike, përfshi dhe internetin. Këto adresa u japin akses studentëve edhe për diskutime në forumet e faqes zyrtare të universitetit. Gjithashtu studentët kanë akses dhe mundësi të zgjerimit të dijeve nëpërmjet sistemit të edukimit “online”, që konsiston në kërkimin në internet të materialeve ndihmëse të studimit, që u kërkohen nga pedagogët.

Në pesë vitet e ardhshme ky sistem do të zhvillohet më tej në drejtime të ndryshme, duke shtuar edhe numrin dhe cilësinë e kompjuterëve.

Në faqen Web të Albanian University, studentët mund të regjistrohen në faqen e Forumit dhe të diskutojnë për probleme të ndryshme, apo tema që lidhen kryesisht me Albanian University.

Pjesëmarrësit në forum specifikohen sipas interesave të tyre, që mund të jenë në lidhje me jetën e studentëve, oraret e kurseve, pedagogët, leksionet, administratën.

Kartat e studentit

Studentët e Albanian University janë të pajisur me kartat e identitetit, që u shërbejnë për identifikim, dhe akses në të gjitha ambientet e Universitetit. Format i kartës, në të cilën janë të shënuara numri i ID-së, numri i Amzës dhe numri i Kartelës së regjistruar në bibliotekë e Universitetit, i shërben studentit për të hyrë në provim, apo për të marrë vërtetime zyrtare nga shkolla. Kartat lejohen të



Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022 Albanian University

përdoren vetëm nga personat e autorizuar në përputhje me kushtet e përdorimit të Albanian University.

Shërbimi me fotokopje

Albanian University ofron shërbime për fotokopjim tekstesh të ndryshme, apo leksionesh si për studentët ashtu dhe për stafin pedagogjik.

Bar-kafe dhe lokale me vetëshërbim

Shërbime për komunitetin

Institucioni, në ndihmë të zhvillimit ekonomik dhe social, ka menduar që në vitet e ardhshme, të ofrojë krahas mësimi, edhe konsulencë, kërkim shkencor të aplikuar dhe shërbime të tjera. Kjo do të jetë e mundur edhe në sajë të zhvillimit në Institucion të zyrës së projekteve ku nga përfitimi i projekteve kombëtarë/ndërkombëtare pritet të gjenerohen të ardhura shtesë. "Klientët" potencialë për këto shërbime do të jenë komunitetet dhe bizneset lokale, organet qeverisëse, vendore dhe qendrore, dhe organizata donatore të ndryshme. Shërbime që mendohet të aktivizohen do të jenë: konsulencë juridike, konsulencë projektimi apo inxhinierike dhe hartime projektesh, shërbime të Psikologjisë, konsulencë farmaceutike, konsulencë ekonomike etj. Do të ofrohen gjithashtu trajnime të ndryshme në fushat në të cilat Institucioni vepron.

6. MARRËDHËNIET ME JASHTË

Institucioni synon të krijojë një strategji dhe implementim operacional afatgjatë në kuadër të marrëdhënieve me jashtë. Kjo marrëdhënie synon të shtrihet dhe zgjerohet me partnere lokale dhe ndërkombëtare në kërkim të bashkëpunimit dhe mirëqenies së interesave të përbashkëta.

Shërbimi i Marrëdhënieve me Jashtë pranë Albanian University, orientimi i së cilit është i përcaktuar nga organet e vendimarrjes, (Rektorati) vihet në jetë nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë.

Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë është në ngarkim të konceptimit dhe vënies në jetë të strategjisë së marrëdhënieve me jashtë dhe vepron nën autoritetin e Rektoratit. Kjo zyrë ndjek administrimin e programeve të shkëmbimit ndëruniversitar, komunikimin, bashkëpunimin e Universitetit me mjedisin social ekonomik vendas ku studentët e Albanian University kryejnë praktikën mësimore si edhe marrëdhëniet dhe universitetet e huaja.

Disa nga funksionet e synuara janë:

➤ Afatshkurtër: Gjetjen, ndjekjen dhe aplikimin e projekteve të ndryshme akademike si: Erasmus+, Horizon 2020, Visegrad Fund for Universities, Marie Curie Scholarships for Academia, shkëmbime pedagogesh dhe studentesh me shkolla të huaja, dhe shumë të tjera.



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

- Afatgjatë: Lehtësim dhe Mundësim të aplikimeve në fonde ndërkombëtare të departamenteve të ndryshme të Universitetit, bashkëpunime të ndryshme me botën e biznesit dhe universitete të tjera ndërkombëtare, etj.
- Ndërveprimet e Universitetit me partneret social ekonomike janë të ndryshme; studentët e Albanian University konsiderohen bashkëpunëtorët e ardhshëm të këtij realiteti dhe ata janë të përgatitur me dije dhe teknikat e duhura për tu integruar në tregun e punës.
- Përveç formimit specifik që ata marrin në Albanian University, ata përftojnë nga eksperiencia në laboratorët dhe atelietë tona bashkohore.
- Bashkëpunimi me këtë realitet synohet për të krijuar mundësi për praktikën mësimore si edhe oferta pune.

Objektivat e Partneritetit me pale të huaja:

- Zbatimi dhe thellimi i mëtejshëm i marrëveshjeve të lidhuara me universitete partnere brenda dhe jashtë vendit, zgjerimi i kontakteve të reja e të mëtejshme, fokusimi tek partnerët strategjikë dhe diversifikimi i i lidhjeve,
- Anëtarësimi në shoqata dhe organizma ndërkombëtarë si edhe pjesëmarrja në aktivitete në kuadrin e këtyre anëtarësimeve,
- Anëtarësimi në projekte zhvillimore dhe operacionale si konsulent akademik dhe krah operativ në iniciativa infrastrukturore, inovative dhe të mirëqenies sociale të Akademisë dhe shoqërisë shqiptare (IPA, Interreg, EU Commission development funds, etc.)

Për më tepër, Strategjia e Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë parashikon këtë plan veprimi:

- Konsolidimi dhe eficientimi i partneriteteve ekzistuese dhe funksionale; si dhe krijimi i marrëveshjeve të reja pragmatike dhe të qëndrueshme të binjakëzimit me institucionet më prestigjioze të arsimit të lartë në vend, BE dhe më gjërë në botë,
- Shkëmbimi i studentëve, kërkuesve dhe profesorëve me universitetet me të cilat është arritur marrëveshja, dhe zhvillimi e konsolidimi i laboratorëve për praktika dhe kërkim,
- Krijimi i partneriteteve për aplikim të suksesshëm në programet e Bashkimit Evropian apo kooperimin rajonal, si: Horizon 2020, Erasmus+, Erasmus Mundus; SCM, etj.
- Bashkëpunimi afatgjatë përmes krijimit të Diplomave të Dyfishta ose në bashkëpunim, apo i departamenteve të përbashkëta për studime, kërkim dhe kooperim integral.

“Albanian University” synon që të jetë pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të OCDE-së, dhe të Bashkimit Evropian. Nder të tjera, ajo ka si vizion dhe qëllim të saj orientimin drejt Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë duke u bazuar kryesisht në Kartën e Bolonjes. Qëllimi dhe misioni i saj është në harmoni të plotë me objektivin e krijimit të një Hapësirë Evropiane të Arsimit të Lartë e cila është bazuar në;



Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2017-2022 Albanian University

Lirinë akademike, autonominë institucionale dhe angazhimin e pedagogëve dhe studentëve në vendimmarrjen e arsimit të lartë.

- Në gjenerimin dhe rritjen e cilësisë akademike, në zhvillimin ekonomik dhe kohezionin social.
- Në nxitjen e pedagogëve dhe studentëve për lëvizjen e lirë.
- Në zhvillimin e dimensionit social të arsimit të lartë.
- Në favorizimin e punësimit dhe të njohurive permanente të të diplomuarve.
- Në konsiderimin e pedagogëve dhe studentëve si pjesë të komunitetit akademik.
- Dhe në hapjen me jashtë dhe në bashkëpunimin me institucione të tjera të arsimit të lartë jashtë vendit.

Në koherencë të plote me politikat e Qeverisë shqiptare mbi arsimin e lartë, Albanian University u është përshtatur reformave institucionale duke riformatuar strategjitë dhe strukturat e saj. Në mënyrë që të realizohet një aderim sa më i plotë i saj në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, në harmoni me legjislacionin e brendshëm, Albanian University ka aplikuar;

- Sistemin e titujve akademike të njehsueshëm (sistemin me tre cikle të studimeve universitare)
- Transparencën e kurseve të studimit dhe kurrikulave, mundësuar nga aplikimi i një sistemi të përbashkët kreditesh, i cili bazohet në ngarkesën e punës, në rezultatet e të nxënësve dhe nëpërmjet Supplementit të Diplomes.
- Njohjen e titujve të studimit dhe periudhës së studimit
- Një qasje të orientuar drejt garantimit të cilësisë
- Vendosjen e një kornize që pëmban tituj të vlefshëm brenda Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Një tjetër hap i rëndësishëm në realizimin dhe nxitjen e bashkëpunimit dhe kooperimit ndërkombëtar, në mbështetje të sa u përmend më lart është edhe programi Erasmus+, një program i aplikueshëm prej 2014 dhe që përmbledh 7 programet e mëparshme; Lifelong Learning Programme (Erasmus, Leonardo da Vinci, Comenius and Grundtvig), Youth in Action, Erasmus Mundus, Tempus, Alfa, Edulink, ICI.

Programi Erasmus+ parashikon tre hapa kryesore të cilët Albanian University në kuadrin e nderkombetarizimit të saj ka në plan të adaptojë, ato janë;

Levizja individuale me qëllim marrjen e njohurive

- Lëvizja individuale në sektorin e arsimit, të formimit dhe të rinisë (Programi Erasmus)
- Diploma Masteri shkencor të përbashkëta (Erasmus Mundus)



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

Bashkepunimi per inovacionin dhe praktikat e mira

- Partneritete strategjike ne sektorin e arsimit, te formimit dhe te rinise
- Bashkëpunim per njohuritë
- Bashkëpunim per aftësitë sektoriale
- Përforcimi i aftësive ne sektorin e arsimit te larte (ish programet Tempus, Alfa, Edulink)

Mbeshtetje e reformës se politikave

- Dialog te strukturuar; takim mes te rinjve dhe vendimmarrësve ne sektorin e rinise.

Ne kuadër të ndërkombëtarizimit dhe të marrëdhënieve me jashtë, Albanian University ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me:

- Universitetin e Studimeve të Palermos,
- Universitetin e l'Aquilas,
- Universitetin Corvinus në Hungari,
- Facultatea di Medecina Dentara Bucharest, Romania,
- Sigmund Freud University Viene,
- Nigbo Dahongying University, China,
- La Sapienza - Department of History, Drawing and Restauration of Architecture (Rome),
- Powislanski College - Poloni nëpërmjet The Institute of Advance Psycological trainings,
- Universita degli studi di Salerno,
- Universita di Pisa,
- Universiteti i Firences,
- Universiteti i Padoves,
- La Sapienza - (Rome),
- Università Cattolica del Sacro Cuore (Rome),
- Institute of International Sociology of Gorizia,
- Universida de Vigo,
- Instituto Superiore di Sanita – Colomed,
- University "Angel Knachev" Ruse, Bulgaria.

Gjithashtu Albanian University ka shtrirë bashkëpunimet e tij edhe në rajon ku aktualisht ka marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin Gjilan Kosovë dhe Kolegjin AAB Prishtinë. Albanian University është pjesë e rrjetit universitar Mediterranean and Middle East University Network. Këto bashkëpunime janë një mjet i domosdoshëm për njohjen e ndërsjelltë të kulturave,



**Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional
2017-2022
Albanian University**

për zhvillimin kulturor, shkencor të njohurive dhe shpërndarjen e tyre, për të nxitur zhvillimin e projekteve të përbashkëta me interes të përbashkët në fushat e projektuara dhe disiplina të caktuara në drejtim të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë.

Në përfundim të dokumentit strategjik, “Albanian University” sheh dhe pengesat që mund të hasë në rrugën e vështirë të përmbushjes së vizioneve dhe planit të veprimit në vitet që vijnë. Disa prej tyre janë të parashtruara më poshtë:

Bërja pasive e disa programeve të studimit për shkak të paqëndrueshmërisë që ka tregu i punës; Zhvillimi i projekteve të përbashkëta arsimore me universitetet evropiane për shkak të kostove të larta dhe mosmbështetjes nga shteti dhe agjencitë përkatëse të tij;

“Albanian University” shpreh besimin e plotë që nëpërmjet stafit të tij të kualifikuar nga ana akademike dhe përkushtimit profesional të administratës së tij do të arrijë të përmbushë me sukses misionin dhe planin e veprimit strategjik të institucionit deri në vitin 2022.

**Propozuar nga Senati Akademik i Albanian University.
Miratuar nga Bordi i Administrimit.
28/12/2016**

Rektor

Prof. Dr. Vera Ostreni

Kryetar i Bordit të Administrimit

Amanda Vrioni